




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI

DREJTORJATI PËR ARSIM



Duke u bazuar në nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe në Nenin 70, pika 70.1 të Statutit të Komunës së Deçanit, datë 04.05.2010, si dhe bazuar në Ligjet që rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr.02/L-52, Ligji Nr.03/L-068, Ligji Nr.04/L-32 dhe Ligji Nr.04/L-138 dhe në funksion të rritjes së cilësisë së arsimit në Komunën e Deçanit, me qëllim që të rritet niveli i transparencës me rastin e punësimit të stafit udhëheqës, profesional e ndihmës në institucionet edukativo-arsimore e aftësuese (IEAA) të kësaj komune. Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) merr:

VENDIM

PËR PROCEDURËN E PËRZGJEDHJES SË MËSIMDHËNËSVE DHE PERSONELIT TJETËR PPROFESIONAL NË IEAA

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në përputhje me Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr.02/L-52, Ligji Nr.03/L-068, Ligji Nr.04/L-32 dhe Ligji Nr.04/L-138 dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse UA Nr.17/2009 dhe UA Nr.09/2014 dhe UA Nr.06/2015.

Procedura e përzgjedhjes është si vijon:

Hapet konkursi publik me të gjitha sqarimet e nevojshme për Kandidatët e interesuar. Konkursi shpallet në gazeta ditore dhe në ueb faqen e Komunës së Deçanit, Më rastin e publikimit të konkursit në ueb faqen e komunës publikohet edhe dokumenti ku përshkruhen kriteret e paraseleksionimit.

Kandidatët duhet të plotësojnë dokumentacionin e tyre në përputhje me kërkesat e konkursit. Gjatë kohës sa është i hapur konkursi pranohen të gjitha aplikacionet e kandidatëve. Pas përfundimit të kohës së aplikimit DKA cakton komisionin vlerësues-intervistues (Komisioni për Zgjedhjen e Personelit Arsimor). i cili përbëhet nga dy përfaqësues të DKA-së dhe nga drejtori i institucionit përkatës. Të gjitha aplikacionet e kandidatëve, përkatësisht të dhënat e tyre futen në databazën elektronike. Aplikacionet e pa kompletuara sipas kërkesave të konkursit dhe kandidatët e pa kualifikuar sipas ligjeve dhe UA të sipërpërmendura nuk merren në shqyrtim dhe nuk futen në databazë.

Nga të gjithë kandidatët, përzgjidhen 3 kandidatë të kualifikuar për intervistim sipas kriterëve të paraseleksionimit përmes databazës (bazuar në kualifikimet formale adekuate, përvojën e punës relevante në arsim, trajnimet e përfunduara relevante të akredituara nga MASHT dhe notën mesatare gjatë studimeve). Nëse i njëjti person aplikon në më shumë se një pozitë/institucion, atëherë për secilën pozitë/institucion duhet të dorëzojë aplikacionin e veçantë të kompletuar. Por, nëse kandidati i plotëson kushtet për t'u ftuar në intervistë, mund të ftohet në intervistë vetëm në një institucion, përkatësisht vetëm për një pozitë. Totali i pikëve të mundshme gjatë paraseleksionimit është 40 pikë. Pas përzgjedhjes së 3 kandidatëve për intervistim komisioni vlerësues-intervistues përgatitë planin dhe formularët e intervistimit, duke shënuar në formularin përkatës (që do të përdoret edhe për intervistim)

pikët e paraseleksionimit të secilit kandidat që do të intervistohet. Pastaj kontaktohen kandidatët e përzgjedhur për intervistim dhe informohen për ditën, datën, kohën dhe vendin e intervistimit (me këtë rast plotësohet formulari (F1))

Të gjithë kandidatët që ftohen për intervistë, duhet të marrin me vete të gjitha dokumentet origjinale që janë kërkuar me konkurs (të cilat me rastin e aplikimit i kanë dorëzuar kopje). Totali i pikëve të mundshme gjatë intervistimit është 50 pikë (nga secili anëtar i komisionit). Intervista me secilin kandidat duhet të zgjasë 10-20 minuta dhe vlerësimi-pikëzimi i tyre bëhet bazuar në udhëzuesin për intervistim. Secili anëtar i komisionit vlerësues-intervistues e bën vlerësimin-pikëzimin për secilin kandidat në mënyrë të pavarur, sipas formularit të intervistimit formulari (F2) dhe sipas udhëzimeve për intervistim.

Pas vlerësimit-pikëzimit të pavarur të antarëve të komisionit vlerësues-intervistues për secilin kandidat, antarët e komisionit mund të diskutojnë rreth performancës së kandidatve gjatë intervistës. Pas diskutimit, secili anëtar i komisionit vlerësues-intervistues i rishikon (nëse ka nevojë) dhe i plotëson formularët për secilin kandidat dhe i nënshkruan formularët. Pas vlerësimit-pikëzimit të pavarur të antarëve të komisionit vlerësues-intervistues për secilin kandidat, plotësohet formulari i përbashkët, ku për secilin kandidat mbledhen pikët nga të gjithë anëtarët e komisionit vlerësues-intervistues formulari (F3). Formulari nënshkruhet nga 3 antarët e komisionit.

Pas mbledhjes së pikëve nga të gjithë anëtarët e komisionit vlerësues-intervistues për secilin kandidat, plotësohet formulari përfundimtar (formulari F4), në të cilin bëhet rangimi i 3 kandidatëve sipas totalit të pikëve, duke përfshirë pikët e paraseleksionimit dhe pikët e intervistimit. Kandidati që ka marrë më së shumti pikë (përfshirë pikët e paraseleksionimit dhe pikët e intervistimit) propozohet për t'u përzgjedhur. Në rast të pikëve të barabarta në mes të kandidatëve, atëherë vendoset sipas pikëve dhe kriterëve të paraseleksionimit. Formulari nënshkruhet nga 3 antarët e komisionit. Propozim-vendimi për përzgjedhjen e kandidatit për t'u punësuar merret pas përfundimit të intervistimit të 3 kandidatëve dhe plotësimit të nënshkrimit të të gjithë formularëve. Të gjithë formularët origjinalë merren në DKA. Propozim-vendimi i komisionit bëhet i plotfuqishëm në momentin e miratimit dhe nënshkrimit të formularit (F4) dhe kontratës së punës nga Drejtori i DKA-së.

Drejtori i DKA-së e miraton propozim-vendimin e komisionit gjithmonë, përveç rasteve kur ndonjëri nga antarët e komisionit nuk e nënshkruan formularin (F4) dhe dorëzon ankesë me shkrim në DKA për jokerrektesi gjatë procesit të vlerësimit-intervistimit, dhe në qoftëse konkludon se gjatë procesit të intervistimit ka pasur parregullsi dhe njëanshmeri nga antarët e komisionit vlerësues-intervistues. Në këto raste drejtori i DKA-së mund të kërkojë intervistimin e serishëm të kandidatëve ose në të kundërtën të anuloi procedurat e intervistimit dhe të përsëritet konkursi për pozitën e caktuar.

Pas përzgjedhjes së kandidatëve, DKA e publikon listën e të përzgjedhurve final në ueb-faqen e komunës. Kandidati i përzgjedhur njoftohet nga DKA dhe informohet për kushtet e kontratës dhe datën e fillimit të punës.

Kandidatët e pakënaqur me vendimin e komisionit vlerësues-intervistues dhe të DKA-së mund të ushtrojnë ankesë.

Deçan: 25.01.2016

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të Komunës
- Drejtorive të IEAA
- DKA-së


Drejtori i DKA-së Deçan

Qazim Maloku

 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - DEÇANA DEÇANE - DEÇAN MUNICIPALITY	
Nga: DKA-Deçan Nr. Protokoll: 02 Nr. Faqe: 02	Nr. Protokoll: 2326 Nr. Protokoll: 2326 Data: 25-01-16

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

**KOMUNA E DEÇANIT**

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI

DREJTORJATI PËR ARSIM

Duke u bazuar në nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe në Nenin 70, pika 70.1 të Statutit të Komunës së Deçanit, datë 04.05.2010, si dhe bazuar në Ligjet që rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr.02/L-52, Ligji Nr.03/L-068, Ligji Nr.04/L-32 dhe Ligji Nr.04/L-138 dhe në funksion të rritjes së cilësisë të arsimit në Komunën e Deçanit, me qëllim që të rritet niveli i transparencës me rastin e punësimit të stafit udhëheqës, profesional e ndihmës në institucionet edukativo-arsimore e aftësuese (IEAA) të kësaj komune. Drejtori i Drejtorjatit Komunal të Arsimit (DKA) përcakton:

**KRITERET PËR PËRZGJEDHJE TË MËSIMDHËNËSVE DHE PERSONELIT TJETËR
PPROFESIONAL NË (IEAA)**

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në përputhje me Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr.02/L-52, Ligji Nr.03/L-068, Ligji Nr.04/L-32 dhe Ligji Nr.04/L-138 dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse UA Nr.17/2009 dhe UA Nr.09/2014 dhe UA Nr.06/2015.

KRITERET PËR PËRZGJEDHJE

Studimet Master (nëse ka): Total 10 pikë Master i fushës përkatëse i përfunduar = 10 pikë Master i fushës përkatëse i papërfunduar = 5 pikë Master i fushës jo përkatëse i përfunduar = 2 pikë Master i fushës jo përkatëse i papërfunduar = 1 pikë <i>Sqarim:</i> Master i fushës përkatëse konsiderohet Masteri që është nga fusha e njëjtë si fakulteti	10 pikë
Përvoja e punës në arsim (vite): Total 10 pikë Pa përvojë = 0 pikë Më pak se 1 vit deri në 1 vit = 1 pikë Më shumë se 1 vit deri në 2 vite = 2 pikë Më shumë se 2 vite deri në 3 vite = 3 pikë Më shumë se 3 vite deri në 4 vite = 4 pikë Më shumë se 4 vite deri në 5 vite = 5 pikë Më shumë se 5 vite deri në 10 vite = 8 pikë Më shumë se 10 vite = 10 pikë	10 pikë

Numri i trajnimeve relevante të akredituara nga MASHT: Total 10 pikë Asnjë trajnim = 0 pikë 1 trajnim = 1 pikë 2 trajnime = 2 pikë 3 trajnime = 3 pikë 4 trajnime = 4 pikë 5 trajnime = 5 pikë 6 –10 trajnime = 8 pikë Më shumë se 10 trajnime = 10 pikë	10 pikë
Nota mesatare gjatë studimeve (fakulteti): Total 10 pikë 6.00 = 0 pikë deri te 10.00 = 10 pikë (shkallëzimi i notës bëhet përmes formulës automatike)	10 pikë
Totali i pikëve	40 pikë

Nëse kandidatët dalin me pikë të njëjta, atëherë vendoset si vijon:

1. Merret parasysh Masteri (1 përkatës i përfunduar ose 2.përkatës i papërfunduar 3 masteri jo përkatës i përfunduar)
2. Merret parasysh përvoja në arsim,
3. Merret parasysh numri i trajnimeve të përfunduara të akredituara nga MASHT
4. Merret parasysh nota mesatare gjatë studimeve (fakulteti).

Sqarim shitesë:

Për pozitat/vendet e punës ku nuk kërkohet kualifikimi universitar do të veprohet në përputhje me UA përkatës sa i përket kriterëve, ndërsa parimet e paraseleksionimit do të vlejnjë me rastin e rangimit të kandidatëve.

Numri i përgjithshëm i poenëve nga të gjitha kriteret duhet të jetë 40 pikë

Deçan:25.01.2016


Drejtori i DKA-së
Qazim Maloku